



Autor: Gen Kelmendi

Debati I cili është hapur pasi që Ministria e Arsimit nëpërmjet një udhëzimi administrativ ndaloi veshjen fetare në shkolla publike, mendoj se është debat i pa nevojshëm. Problemi nuk qëndron tek qeveria apo me konkretisht tek Ministra e Arsimit, mirëpo i gjithë faji është tek mungesa e juristëve, pra faji për ndalimin e bartjes së uniformes fetare në shkollat publike, nuk është vetëm i qeverisë por është i gjithë shoqërorë, dhe ata të cilët këtë vendim e konsiderojnë si diskriminim fetar, është pikërisht faji tek ta, ngase ata nuk dinë si ta kundërshtojnë atë vendim administrativë dhe nuk janë të aftë të sjellin argumente që një ndalesë e tillë është diskriminim i të drejtave dhe lirive universale të njeriut. Pra i gjithë faji qëndron tek mungesa e juristëve.

Do i sjelli dy (2) argumente juridike që ndërlidhen me aspektin logjikë të kësaj teze të shumëpërfolur, dhe ne si shoqëri kosovare që çdo herë kemi synim të aspirojmë vlera evropiane duhet që me automatizëm të ju përmbahem këtyre dy argumenteve;

E Para: Udhëzimi administrativ i cili ndalon veshjen fetare nëpër shkolla publike, në fund të fundit, është veçse një udhëzim administrativ, I cili për nga fuqia juridike është më i dobët përball një mori argumentesh dhe nene që janë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe në Konventat evropiane Për Të Drejtat E Njeriut. Dhe në të njëjtën kohë, ky udhëzim administrativë është i kundër ligjshëm dhe diskriminues, si me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ashtu edhe me Konventat Evropiane Për Lirit Dhe Të Drejtat E Njeriut, dhe në këtë rast juristet tanë do të duheshin të reagonin me automatizëm për këtë vendim joligjor.

E Dyta: Ata të cilët e mbrojnë këtë vendim, thirren në atë se ne jemi shtet laik dhe institucionet e shtetit tonë janë laike. Ne u themi atyre se nëse nxënëset që bartin uniformë fetare nuk kanë

të drejt shkollimi në shkollat fillore dhe ato të mesme, pasi që janë institucione laike, atëherë përse studentet e universiteteve nuk pengohen nga shkollimi i tyre, pasi që edhe universitetet janë institucione shtetërore (laike) ? Dhe ata për të dal nga kjo situatë e sikletshme, do të thonë: “Universitet edhe pse janë institucione shtetërore laike, studentet që kanë uniformë fetare u lejohet ta bartin dhe nuk pengohen ngase është bindja e tyre dhe zgjedhja e tyre, ndërsa nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme nuk u lejohet që të bartin uniformë fetare, ngase ata ende nuk janë të rritur dhe mund të jenë të ndikuar nga ndokush, pra ende nuk janë mbi 18 vjeç”. Atëherë ne u themi: “Derisa nuk ka një vendim preciz dhe të çart ku thuhet “nxënëset të cilat nuk i kanë mbushur 18 vjet nuk u lejohet vijimi shkollorë ngase mund të jenë të ndikuar nga ndokush” atëherë nuk ka asnjë të drejtë ligjore dhe juridike që Ministria e Arsimit t’i ndalojë nga shkollimi vajzat që bartin uniformë fetare, pra, derisa nuk kemi një ligj që specifikon dhe qartëson qartë se “duhen të jenë mbi moshën 18 vjeçare”. Dhe në këtë rast debati ynë me ta përfundon.

Do të sjelli disa argumente dhe nene nga Konventa Evropiane Për Të Drejtat E Njeriut, të cilat qartësojnë dhe mbrojnë liritë fetare, dhe shprehjen e bindjeve fetare.

Konventa e mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore amenduar sipas Protokollit n° 11

Qeveritë nënshkruese, Anëtare të Këshillit të Evropës,

Duke pasur parasysh Deklaratën universale të të Drejtave të Njeriut, të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948;

Duke pasur parasysh se kjo Deklaratë ka për qëllim të sigurojë njohjen dhe zbatimin universal dhe efektiv të të drejtave të shpallura në të;

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është që të realizojë një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të tij dhe se një nga mjetet për të arritur këtë qëllim është mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore;

Duke ripohuar përkushtimin e tyre të thellë ndaj këtyre lirive themelore që përbëjnë vetë themelet e drejtësisë dhe të paqes në botë dhe ruajtja

e të cilave mbështetet kryesisht mbi një regjim politik me të vërtetë demokratik, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, mbi një koncept dhe respekt të përbashkët të të drejtave të njeriut që ato kanë marrë përsipër të mbrojnë;

Të vendosura, si qeveri të Shteteve evropiane që shtyhen nga e njëjta frymë dhe që kanë një pasuri të përbashkët të idealeve dhe të traditave politike, të respektimit të lirisë dhe të epërsisë të së drejtës, të marrin masat e para të përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale;

Janë marr vesh për sa vijon:

Neni 9 - Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si edhe lirinë për të shfaqur fenë e tij ose bindjet e tij individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve.

Neni 14 - Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike ose çdo opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër

Protokoll shtojcë i Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive themelore

Qeveritë nënshkruese, Anëtare të Këshillit të Evropës,

Të vendosura që të marrin masat e përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të të drejtave dhe të lirive të tjera nga ato që

figurojnë tashmë në Titullin I të Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të

Njeriut dhe të Lirive themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor

1950 (e quajtur më poshtë "Konventa"),

Janë marrë vesh për sa vijon:

Neni 2 - E drejta për arsim

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Tani do ti sjellim disa argumente dhe nene nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, të cilat flasin për të drejtat dhe liritë fetare, të cilat janë shumë në numër, dhe të cilat fuqizojnë argumentin që përmendem më lart se ai udhëzim administrativ për ndalimin e uniformes fetare në shkollat publike është diskriminues dhe joligjor edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 47 [E Drejta për Arsimin]

1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor...
2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.

Neni 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë]

1. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar.
2. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personal..
3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj.

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë

ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj....

Këto të drejta kanë fuqizimin edhe nga marrëveshjet ndërkombëtare, dhe disa nene të Kushtetues së Republikës së Kosovës flasin për këto marrëveshje ndërkombëtare;

Neni 17 [Marrëveshjet Ndërkombëtare]

2. Republika e Kosovës merr pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut.

.....

Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]

- 1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik...
- 2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Andaj, pa dashur të ekzagjerojmë problemin më shumë, prekëm problemin në thelb, dhe pamë që edhe me konventa evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, edhe me Kushtetutë të Republikës së Kosovës, kjo qasje dhe ky vendim i lëshuar nga Ministria e Arsimit për ndalimin e bartjes së uniformës fetare në institucione shkollore, është diskriminues, joligjor, anikushtetues, dhe thyerje e parimeve themelore të të drejtave dhe lirive universale të njeriut.

Joprofesionalizmi i juristëve tanë ka pruar çështjen deri këtu ku nuk është dashur të ngrihet ky diskutim, dhe më e keqja e gjithë kësaj është se ende shumica e juristëve arsyetojnë vendimin e Ministrisë së Arsimit dhe thirrën në atë se shteti jonë është shtet laik, term të cilin as ata vetë nuk arrijnë që ta kuptojnë, se lëre më të zhyten në konceptin dhe thelbin e asaj çështje.

Shteti i Republikës së Kosovës ka kaluar sfida edhe më të vështira, andaj konsideroi se edhe këtë “problem” do e tejkalojmë, problem të cilin nuk është dashur ta sjellim deri në këtë gjendje, ku qytetarët e Republikës së Kosovës të manipulohen me termat e laicitetit, ekstremitetit, instalimit fundamentalist Islamik e shumë çështje të tjera, gjë të cilat janë të pa nevojshme të diskutohen në diskursin aktual politikë.

(Autori është student i Fakultetit Juridik)